



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE (QRK) NR.20/2023 PËR PLOTËSIMIN DHE NDYSHIMIN E
RREGULLORES (QRK) Nr. 08/2017 PËR DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE
PROCEDURAT E KOMISIONEVE TË AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM
DHE VERIFIKIM TË PRONËS¹**

¹ Rregullorja (QRK) Nr.20/2023 për Plotësimin dhe Ndysimin e Rregullores (QRK) Nr.08/2017 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Procedurat e Komisioneve të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, është miratuar në Mbledhjen e 178-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 11/178 të datës 13.12.2023.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 , paragrafi 7 të Ligjit Nr.05/L-010 Për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-052, nenin 8, paragrafit 4, nënparagrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, nr. 15, 12 shtator 2011).

Miraton:

RREGULLORE (QRK) NR 20/2023 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (QRK) NR. 08/2017 PËR DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE PROCEDURAT E KOMISIONEVE TË AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e rregullores (QRK) nr. 08/2017 për detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e komisioneve të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Neni 2

1. Neni 11 të rregullores bazë i shtohet një paragraf i ri 6A me tekstin si në vijim:

6A. KKP vendos për njohjen ligjore të të drejtave joformale pronësore sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore dhe Ligjit nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L0 -010 për AKKVP.

6.1 KKP vendos mbi të drejtën joformale me vendim për:

6.1.1 njohjen e të drejtës joformale pronësore dhe urdhëron regjistrimin e pronës në regjistrin e të drejtave të pronës se paluajtshme;

6.1.2 refuzim apo hedhje poshtë të kërkesës për njohjen e të drejtës joformale pronësore.

Neni 3 Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës
05 Janar,2024

